



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:159457

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05675818

**Ac.nr.4577/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare, Adnan Konushevci dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.A. nga fsh. D., Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.A. avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria për Arsim në Kamenicë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H., për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, C.nr.98/2019, të datës 05.02.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 13.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria për Arsim në Kamenicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, C.nr.98/2019, i datës 05.02.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

**I. APROVOHET** padia dhe kërkesëpafia e paditësit E.A. nga fsh.D., Komuna e Gjilanit.

**II. OBLIGOHET** e paditura Komuna e Kamenicës që paditësit t'ia paguaj:

-në emër të tri pagave mesatare me rastin e shkuarjes në pension në shumë prej 1,373.70 euro,

-në emër të pagës jubilarë për 40 vite të paditura në shumë prej 607.80 euro.

Gjithsejtë shumën prej 1,981.29 euro, me kamate ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga 09.07.2019, ditë e parashtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi.

**III.OBLIGOHET** e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 30 euro, për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për tri seanca të mbajtura shumë prej 135 euro, përkatësisht shumë prej 405 euro, apo gjithsejtë 539 euro, ne afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, me kërcënim të përmbarimit te dhunshëm''.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e të paditurës, aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- **Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi përmes të autorizuarit në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi me datë 09.07.2019, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit me rastin e pensionimit me datë 18.05.2017, t'ia paguaj tri paga përcjellëse, në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite të përvojës së punës t'ia paguaj një pagë, të gjitha këto me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi dhe në seancë gjyqësore e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se Kontrata Kolektive e Arsimit para universitar e vitit 2015 është shfuqizuar, si dhe nga fakti se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuuese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimin të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimin, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike

me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike bazuar në shkresat e lëndës të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, nga ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësi ishte në marrëdhënie pune te e paditura ndërsa me Vendimin nr.146 të datës 18.05.2017, i është ndërprerë marrëdhënie e punës sipas fuqisë ligjore për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Po ashtu nga vërtetimi nr.198 i datës 01.07.2019 është vërtetuar se paditësi në SHFMU "Rexhep Mala" në T., ka punuar për periudhën kohor prej 26.09.1994 deri me 17.05.2017 dhe ka 23 vite përvojë pune, ndërsa nga librezja me numër të regjistrimit 20204/75 e lëshuar në emër të paditësit është vërtetuar se për periudhën kohore nga 01.09.1975 deri me 26.09.1994 ka përvojë pune në kohëzgjatje prej 17 viteve, 9 muaj dhe 17 ditë, me çka është vërtetuar se paditësi ka gjithsejtë 40 vite përvojë pune. Ndërkaq nga lista e të ardhurave personale EM 00007574 e lëshuar në emër të paditësit është vërtetuar paga bazë e paditësit në shumë prej 405 euro.

Me dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 pika 3 të Kontratës Kolektive për Arsim në Kosovë te datës 18.04.2017 është e paraparë *se punëtorët ( anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit , për 10 vjet të përvojës së punës , në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vite të përvojës së punës , në vlerë të 75% të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 150% të një page bazë . Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse, dhe me dispozitën e nenit 35 paragrafi 9 i po të njëjtës i cili parashihet se: *Punëtorët ( anëtar të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit. 9.1 Pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionit.* Gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë, duke e detyruar të paditurën që paditësit për 40 vite përvojë pune, ti paguajë në lartësi prej 150 % të një page bazë në emër të shpërblimit jubilar, shumë prej 607.80 €, si dhe për tri paga për përcjellje në pension në shumë prej 1,373.79 €, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e cila është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.*

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se

obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Pretendimi ankimor i të paditurës *se sa i përket kërkesës së paditësit e njëjta është vjetërsuar*, është i paqëndrueshëm për faktin se paditësi ka parashtruar padinë në gjykatë me datën 09.07.2019, në kohën kur ka qenë në fuqi Marrëveshja Kolektive e Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi prej datës 18.04.2017, dhe kjo e drejtë e paditësit i ka filluar prej kësaj date, dhe ka qenë në fuqi deri me datë 18.04.2020, dhe në bazë të nenit 45 të kësaj kontrate është paraparë se “*Nëse nga Kontrata Kolektive pasi ti skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit, Këtë fakt e ka vërtetuar edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, referuar mendimit juridik të saj (mendimi juridik për shpërblim jubilar dt.27.02.2023, faqja 2, parag.IV), ku parashihet se: ‘Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), (në tekstin e më tejme: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017) aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017-21.01.2021’*”. Andaj nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim në rastin konkret pasi që paditësi padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 09.07.2019, ndërsa paditësi është pensionuar me datë 18.05.2017 dhe nuk ka kaluar afati tre vjeçar i parashkrimit siç përcaktohet me dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4577/2021, me datë 13.05.2024**

**Kryetare e Kolegjit**  
**Naime Ahmeti, d.v.**